



## TERMOCENTRAL QË RRIT PUNËSIMIN

Termocentrali "Kosova e Re" do të ketë ndikim pozitiv dhe të shumëfishtë në punësim.

Vetëm gjatë fazës së ndërtimit do të krijohen rreth 10 mijë vende direkte të punës si dhe mijëra vende indirekte të punës si rezultat i furnizimeve në termocentral, duke nxitur zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik dhe social të vendit.

Me të përfunduar ndërtimi dhe kur termocentrali bëhet operacional, do të krijohen qindra vende pune afatgjatë për të operuar dhe mirëmbajtur impiantin e ri.

Po ashtu, me ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re" garantohet vazhdimi i ekzistimit të industrisë minerare të thëngjillit në Kosovë, e cila për dekada ka ndikim shumëdimensional në qëndrueshmërinë ekonomike të vendit, nga ku do të ruhen dhe gjenerohen vende punë për 40 vitet e ardhshme të operimit të termocentralit të ri.

"Kosova e Re" do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik e social në Kosovë, do të eliminoj varshmërinë nga importet dhe humbjet e vazhdueshme në ekonomi si pasojë e mungesës së energjisë.

